REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

PROCES VERBAL PËR KËSHILLIM ME PUBLIKUN

PËR

"DRAFTIN E PROJEKT PLANIT BUXHETOR AFATMESËM 2027-2029 TË BASHKISË SHKODËR"

Konsultim publik : Njësia administrative: Postribë.

Data : *18.09.2026* **Ora** : *13.00* **Vendi:** *Pranë Komunës.*

Numri i pjesëmarrësve : *Numri i pjesmarrësve 25, nga të cilat 4 gra.*

Titulli i Projekt-aktit që konsultohet : *Për draft-projekt planin buxhetor afatmesem 2027-2029 të Bashkisë Shkodër.*

Pjesëmarrës : Drejtues dhe specialistë të administratës së Bashkisë Shkodër dhe banorë (Bashkangjitur listë prezenca).

Takimi drejtohet nga Kryetari i Këshillit Bashkiak i cili bën një prezantim të shkurtër në lidhje me :

- Projekt-aktin e propozuar
- Shpjegoi qëllimin e konsultimit publik
- Shtroi pyetjet konkrete për pjesëmarrësit
- Dha informacion për mënyren e dhënies së rekomandimeve.
- Ju dha fjalën pjesëmarrësve

I. Paraqitja e Programit Buxhetor Afatmesëm dhe projektbuxhetit

Takimi u hap nga **z. Oltion Luli,** Kryetar i Këshillit Bashkiak Shkodër, i cili sqaroi se qëllimi i këshillimit ishte marrja e mendimeve dhe propozimeve të banorëve për nevojat dhe prioritetet që duhet të reflektohen në planifikimin buxhetor të vitit 2027 dhe në PBA 2027-2029.

Në paraqitje u kërkua që diskutimet të fokusoheshin te funksionet dhe shërbimet e Bashkisë Shkodër, përfshirë infrastrukturën rrugore, ndriçimin publik, pastrimin dhe menaxhimin e mbetjeve, ujësjellës-kanalizimet, kanalet kulluese e vaditëse, objektet arsimore dhe shëndetësore, shërbimet sociale dhe nevojat e tjera të komunitetit. Pjesëmarrësit u ftuan të përcaktonin prioritetet kryesore për zonat e tyre.

II. Diskutimet, kërkesat dhe propozimet

Znj. Laura Egerci, drejtoreshë e kopshtit: Kërkoi ndarjen e kopshtit nga ambientet e shkollës dhe zgjerimin e kapaciteteve fizike, pasi kërkesat për regjistrimin e fëmijëve janë të larta dhe mungesa e hapësirave i detyron të mos pranojnë të gjithë fëmijët. Sqaroi se kopshti përdor vetëm dy klasa të shkollës dhe tualetet janë të përbashkëta, gjë që nuk është e përshtatshme për fëmijë të moshës 3-vjeçare.

Znj. Edlira Alija, drejtoreshë shkolle: Falënderoi Bashkinë për bashkëpunimin dhe investimin në fushat moderne e bashkëkohore dhe për bashkëpunimin me komunitetin. Kërkoi investim në një godinë për kopshtin dhe hapjen e një grupi për moshën 3-vjeçare. Sqaroi se shkolla ka rreth 430 nxënës, kopshti 56 fëmijë dhe kërkesat e tjera janë refuzuar për mungesë ambientesh. Propozoi ndërtimin e një godine në një cep të oborrit të shkollës ose marrjen me qira të një ambienti të përshtatshëm.

Z. Oltion Luli, Kryetar i Këshillit Bashkiak Shkodër: Pyeti nëse në zonë kishte ndonjë godinë publike që kishte humbur funksionin dhe mund të përdorej për nevojat e kopshtit.

Z. Avenir Çela: Sqaroi se nuk kishte një godinë të tillë të disponueshme.

Z. Jetmir Zukthi, drejtor shkolle: Ngriti gjendjen e shkollës së Dragoçit, ku sipas tij nuk ka pasur investim që prej vitit 2002. Vlerësoi ndërhyrjen në shkollën "Adem Haxhija", por kërkoi trajtimin e shkollës së Dragoçit, me rreth 130 nxënës: oborri mbushet me ujë, dyert dhe dritaret janë të amortizuara, ndërsa nevojitet edhe sistemimi i rrugës.

Z. Xhevahir Lumaj: Kërkoi investime në Dragoç dhe Fshatin e Ri, duke theksuar mungesën e rrugëve, ndriçimit, ujit dhe kanaleve vaditëse. Sipas tij, banorët detyrohen të kryejnë vetë pastrime dhe mirëmbajtje. Kërkoi gjithashtu zgjidhje për transportin e fëmijëve drejt shkollës.

Z. Maliq Curri, Drisht: Ngriti problematikat e ujit të pijshëm edhe pas ndërtimit të ujësjellësit; kërkoi sistemimin e rrugës së varrezave në Drisht dhe shtimin e ndriçimit në Lagjen e Re, rreth 300 m, ku shtyllat ekzistojnë dhe nevojiten rreth 4-5 ndriçues. Kërkoi që fermerëve t'u lirohet një hapësirë për tregtimin e produkteve, trajtimin e kanalit vaditës nga Ura e Shtrenjtë deri në Kullaj dhe rimbursim për dëmet nga zjarri në ullishte dhe pemëtari.

Z. Xhevdet Karmaj: Theksoi nevojën që kryetarët e fshatrave të organizojnë komunitetin për pastrimin e kanaleve, veçanërisht aty ku ka edhe ujëra të zeza. Ngriti problematikat me rrjetin e amortizuar të OSHEE-së, tensionin elektrik dhe transformatorët. Kërkoi gjithashtu ndërhyrje për

lerat që shërbejnë për bagëtitë e imta, verifikim të sigurisë dhe cilësisë së ujit të ujësjellësit të Rasekut dhe funksionalizimin e kanalit vaditës të Postribës, ku sipas tij mungon uji.

Zv.Kryetari i Bashkisë Z. Marjan Ndershtiqaj: Sqaroi se problematika e rrjetit elektrik do të ndiqet për zgjidhje.

Banor i zonës: Ngriti shqetësimin se mjeti që përdorte elektricisti i zonës ishte hequr nga shërbimi, ndaj banorët detyroheshin ta merrnin vetë punonjësin me mjete private për ndërhyrjet në terren.

Z. Indrit Hysaj, mësues: Kërkoi që takimet e konsultimit të prodhojnë rezultate konkrete dhe jo të mbeten formale. Theksoi se në takimet e mëparshme janë vendosur prioritete, ndërsa rruga e Myselimit ende nuk ishte realizuar.

Z. Marjan Ndershtiqaj: Sqaroi se projekti për rrugën e Myselimit ishte dërguar për financim pranë Fondit Shqiptar të Zhvillimit.

Z. Nesret Velija, Mes-Myselim: Ngriti problematikën e furnizimit me ujë të pijshëm me orar dhe rrezikun e përzierjes me ujin e kanalit të Shtodrit. Kërkoi kontrollin e lidhjeve dhe çezmave në banesa ku nuk ka banorë, ngritjen e një grupi inspektimi shtëpi më shtëpi dhe trajtimin e faktit që faturimi vijon edhe kur mungon furnizimi me ujë.

Z. Fatmir Lisaj, kryetar i fshatit Vilzë: Falënderoi strukturat për gatishmërinë gjatë zjarreve në zonë. Kërkoi nivelimin e rrugës së Vilzës me fadromë dhe mbushjen e saj me çakull.

Z. Muharrem Lisaj, banor i fshatit Vilzë: Sqaroi se familja kishte investuar në rreth 500 rrënjë ullinj dhe synonte zhvillimin e agroturizmit. Kërkoi ndihmë për dokumentacionin, regjistrimin e biznesit, legalizimin e banesës dhe tokës dhe regjistrimin si fermer. Ngriti gjithashtu çështjen e legalizimit të shkollës 9-vjeçare të ndërtuar me kontributin e komunitetit, mungesën e energjisë elektrike në shkollë dhe nevojën për ndërhyrje në rrugën e Cukalit.

III. Evidentimi i prioriteteve dhe dokumentacioni

1. Krijimi ose sigurimi i një godine të dedikuar për kopshtin, zgjerimi i kapaciteteve dhe hapja e grupit 3-vjeçar.
2. Rikonstruksioni i shkollës së Dragoçit dhe sistemimi i oborrit, dyerve, dritareve dhe aksesit rrugor.
3. Investime në rrugët e Dragoçit, Fshatit të Ri, Myselimit, Vilzës dhe Cukalit, si dhe transport për nxënësit.

4. Shtimi i ndriçimit publik, veçanërisht në Lagjen e Re në Drisht dhe zonat pa mbulim.
5. Përmirësimi i furnizimit me ujë të pijshëm, kontrolli i cilësisë së ujit dhe adresimi i faturimeve në zonat me furnizim problematik.
6. Funksionalizimi dhe pastrimi i kanaleve vaditëse, përfshirë segmentin Ura e Shtrenjtë-Kullaj dhe kanalin e Postribës.
7. Përmirësimi i rrjetit elektrik, tensionit dhe logjistikës së shërbimit të elektricistit.
8. Mbështetje për fermerët dhe familjet e prekura nga zjarret, përfshirë dokumentacionin, regjistrimin, agroturizmin dhe rimbursimin e dëmeve.
9. Sistemimi i rrugës së varrezave në Drisht, mbështetje për tregun e fermerëve dhe zgjidhje për lerat e bagëtive.

Kërkesat, vërejtjet dhe propozimet e mësipërme administrohen si pjesë e dokumentacionit të këshillimit publik për Programin Buxhetor Afatmesëm 2027-2029 dhe projektbuxhetin vjetor 2027. Ato pasqyrojnë ndërhyrjet dhe prioritetet e paraqitura gjatë takimit dhe nuk përbëjnë vendimmarrje të pjesëmarrësve.

SEKRETARE

Sabina Danaj

Zbardhi proces verbalin:

Bekim Mema

Irma Sulishti

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

LISTË PREZENCË

KONSULTIM PUBLIK: ***" PËR DRAFT PROJEKT PLANIN BUXHETOR AFATMESEM 2027-2029 TË BASHKISË SHKODËR"***

Njësia Administrative Postribë ***Datë: 18.09.2026***

NR.	EMRI MBIEMRI	LAGJJA/FSHATI	KONTAKT (tel)	e-mail	FIRMA
1.	Altin Shoshi	- Boks	0672626866		
2.	Elida Spahiu	Dragoç	0682180432		
3.	Enver Bakaj	Bokë	0684591472		
4.	Mahmoud Likaj	Vilë	0684678025		
5.	VLADIMIR HASAJ	DRAGOÇ	067692939		
6.	Col Celaj	Dragoç			
7.	Hajdar Ahmeti	B. Shkodër	062315161		
8.	Laura Epçeri	D. Kopshtit	0674087110		
9.	Edlira Alijaj	Meyselem	0674472271	edlira_alijaj@hotmail.com	
10.	Malo Ceka	Driolt	0684125757		

NR.	EMRI MBIEMRI	LAGJJA/FSHATI	KONTAKT (tel)	e-mail	FIRMA
11.	BESNIK BAHIMAJ	MES			
12.	Xhenetir Ismaj	Fshetiki			
13.	Ylvie Selo	DPMOP	0695911374		
14.	Elsid Sadiku	NSHPP	0693810646	elsid.sadiku@hidrodrin.gov.al	
15.	Muhamet Mece	NSHPP	0682082375		
16.	Fatbardh Kuçi	NSHPP	0676305001		
17.	Ekrem Celiku	MNDEH	0694788888	ekrem.celiku@hidrodrin.gov.al	
18.	Theodet Lavrnja	Bokë	0682701955		
19.	Jetmir Curaj	Dragoç	0673377343	jetmir-curaj@hotmail.com	
20.	Dion Kalla	Durrës	0682133820		
21.	Fatmir Liço	VIS	0682211178		
22.	Rifat Brahimaj	MES			
23.	Indrit Hysaj	Myselim	0673395832		
24.	Rexhep Braçi	Domen	0683165271		
25.	Jurgena Braçaj	Dragoç	0677388105	jurgenabracaj11@gmail.com	
26.					
27.					
28.					
29.					
30.					